

ZBATIMI I OBJEKTIVAVE TË EFIÇENCËS SË ENERGJISË NË SHQIPËRI

RAPORT MONITORUES MBI PËRGATITJEN
E LEGJISLACIONIT DHE ZBATIMIN E TIJ

TETOR 2018

PËRGATITI:

ING. HYSNI LAÇI

MSC.ARK. AJDA ÇARÇANI



Public Dialogue
on the Sustainable Use of
Energy in South-East Europe

Ky publikim është përgatitur nga Akademia e Studimeve Politike, në kuadër të Fondit të Hapur Rajonal për Evropën Juglindore - Efienca e Energjisë (ORF-EE), e zbatuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) dhe financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ).

Përmbajtja e këtij publikimi nuk pasqyron opinionin zyrtar të donatorëve dhe zbatuesve të programit. Përgjegjësia për informacionin dhe pikëpamjet e shprehura në publikim i përketin tërësisht autorëve.

ZBATIMI I OBJEKTIVAVE TË EFIÇENCËS SË ENERGJISË NË SHQIPËRI

RAPORT MONITORUES MBI PËRGATITJEN
E LEGJISLACIONIT DHE ZBATIMIN E TIJ

TETOR 2018

Përmbledhje

Autorët e punimit	2
Lista e shkurtimeve	2
Hyrje.....	3
Situata aktuale	5
Përfundime.....	12
Rekomandime	13
Burimet.....	16

Autorët e punimit



Ing. Hysni Laçi është një inxhinier elektrik i kualifikuar me eksperiencë 40 vjeçare në projektimin e sistemeve të prodhimit në sektorin e energjisë. Z. Laçi ka gjithashtu një përvojë të gjerë në ofrimin e konsulencave ndërkombëtare në sektorin e Efiçencës së Energjisë dhe Energjive të Rinovueshme. Ai ka shërbyer gjithashtu si lektor pranë Universitetit Politeknik të Tiranës duke qënë bashkëautor dhe këshillues për më shumë se 16 diploma bachelor & Master, 12 projekte inxhinierike në EE dhe BRE, si dhe dokumente shkencore diskutimi në fushën e energjisë. Nga viti 1996 është anëtar i Shoqatës Shqiptare të Inxhinierëve Elektrikë si dhe anëtar i Këshillit Shqiptar të Energjisë, i cili është anëtar i Këshillit Botëror të Energjisë (WEC).



Msc. Ark. Ajda Çarçani është një arkitekte me mbi 6 vjet përvojë në projektme dizajn të ndërtesave si dhe mësimdhënie. Ajo gjithashtu është çertifikuar si audituese e Efiçencës së Energjisë në ndërtesa dhe ofron konsulencën e saj në çështjet e efiçencës së energjisë pranë Institutit Barleti për Hulumtim dhe Zhvillim. Znj. Çarçani është lektore pranë Universitetit "Marin Barleti" duke ofruar ekspertizën e saj në zhvillimin e kurrikulës dhe mësimdhënien në nivelin universitar të dizajnit të peizazhit, kompozimit arkitektonik dhe programit CAD. Është gjithashtu pjesëmarrëse në trajnime dhe konferenca të ndryshme ndërkombëtare në këtë fushë.

Lista e shkurtimeve

- AEE** - Agjencia për Efiçencën e Energjisë
- AKBN** - Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
- BRE**-Burimet e Rinovueshme të Energjisë
- EE**- Efiçenca e Energjisë
- ESCO** - Kompani për Shërbime Energjetike
- FEE** - Fondi i Efiçencës së Energjisë
- MIE** - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- MZHU** - Ministria e Zhvillimit Urban
- PKVEE** - Plani Kombëtar i Veprimeve i Efiçencës së Energjisë
- TKE** - Traktati i Komunitetit të Energjisë

Hyrje

Shqipëria po përgatitet për hapjen e negociatave në muajin Qershor 2019 për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Anëtarësimi kërkon miratimin dhe zbatimin e të gjithë legjislacionit dhe standarteve përkatëse të BE-së në të gjitha aspektet e çështjeve sociale dhe ekonomike, ku Energjia dhe Mjedisi përbëjnë dy prej sektorëve tepër të rëndësishëm. Strategjia aktuale e BE-së e vlerëson efikasitetin e energjisë dhe përdorimin e energjive të rinovueshme si një prioritet për zhvillimin ekonomik dhe të përgjithshëm të çdo vendi. Si anëtare e Komunitetit të Energjisë, Shqipëria është e angazhuar për të ndjekur këtë prirje, duke adoptuar legjislacionin në përputhje me Acquis të BE për Efikasitetin e Energjisë, Energjive të Rinovueshme etj, dhe të përgatisë periodikisht Planet Kombëtare të Veprimit, monitorimin dhe raportimin mbi realizimin e objektivave të energjive të rinovueshme, efikasitetit të energjisë dhe reduktimit të emetimeve të gazrave me efekt serë.

- Në zbatim të këtyre detyrimeve, në nëntor 2015 Kuvendi i Shqipërisë miratoi **ligjin Nr. 124 dt. 05.11.2015 „Për efikasitetin e energjisë“**¹, si mekanizëm për transpozimin e Direktivës 2012/27 të BE „Për Efikasitetin e Energjisë“². Ky ligj hyri në fuqi në 9 Dhjetor 2015 duke parashikuar që të sillte rezultatet e para dhe ngritjen e institucioneve të reja brenda 12 muajve në vijim.
- Një vit më vonë, Kuvendi miratoi **ligjin Nr. 116/2016, datë 10.11.2016 „Për performancën e energjisë së ndërtesave“**³. Ligji parashikon që të gjitha aktet nënligjore të hartohen dhe aprovohen brenda 12 muajve në vijim.
- Në janar të vitit 2017 Kuvendi miratoi **ligjin Nr.7/2017 „Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme“**⁴.
- Në korrik të vitit 2018 Këshilli i Ministrave miratoi **VKM „Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018-2030“**⁵.

Disa nga risitë që parashikohen të sjellin këto ligje si dhe akte detyrësore janë:

- Krijimi i Fondit të Efikasitetit të Energjisë - Fondi do të përdoret për:
 - (i) financimin e drejtpërdrejtë dhe promovimin e programeve për përmirësimin e efikasitetit të energjisë;
 - (ii) për fuqizimin e kompanive të shërbimeve energjetike;

1 Ligji Nr. 124 dt. 05.11.2015 - https://www.parlament.al/wp-content/uploads/sites/4/2015/10/ligj_nr_124_dt_12_11_2015_24797_1-1.pdf

2 Direktiva 2012/27 amendon direktiven 2010/30 "Për bartjen e shënimit me anë të etiketimit dhe informimit standard të produktit në lidhje me konsumin e energjisë dhe burimeve tjera nga ana e produkteve relevante për konsumin e energjisë" dhe shfuqizon direktiven 2006/32 "Për efikasitetin e përfundimit fundor të energjisë dhe shërbimet energjetike".

3 Ligji Nr. 116/2016, datë 10.11.2016 "Për performancën e energjisë së ndërtesave" - http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/226-2016.pdf

4 Ligji Nr.7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme" - http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2017/PDF-2017/26-2017.pdf

5 VKM "Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018-2030" - <http://qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20119/VKM%20nr.%20480,%20date%2031.7.2018.pdf>

- (iii) për të liçencuar dhe aftësuar ekspertët e pavarur të energjisë dhe audituesit energjetikë;
 - (iv) për të kryer auditimin e energjisë tek kompanitë publike të shpërndarjes së energjisë, operatorët e sistemit të shpërndarjes, kompanitë e shitjes me pakicë të energjisë;
 - (v) aftësimin bashkëkohor dhe instaluesit e pajisjeve me efikasitet të lartë duke kërkuar klasa energjie të përparuara.
- Krijimin e Agjencisë së Efikasitetit të Energjisë, e cila nëpërmjet Fondit të Efikasitetit të Energjisë do të mbështesë:
 - (i) Grantet për investime me kosto të ulët të EE-së për grupet në nevojë;
 - (ii) Auditimet e energjisë për Ndërtesat publike;
 - (iii) Grantet për auditime energjetike të ndërtesave rezidenciale shumëkatëshe, shërbimeve komerciale dhe të industrisë;
 - (iv) Kreditë me norma interesi më të ulëta nga Institucione Financiare Ndërkombetare për investimin e EE-së në ndërtesat publike;
 - (v) Studime të hollësishme mbi mekanizmat e përshtatshëm fiskalë për të mbështetur investimet e EE-së, veçanërisht në lidhje me uljen e TVSH-së për investimet e zgjedhura të EE-së;
 - (vi) Skemat specifike të financimit për grupet e familjeve në nevojë (me të ardhura të vogla) (p.sh. një mekanizëm „Paguani investimin duke Kursyer“);
 - (vii) Studime të hollësishme mbi varfërinë energjetike dhe përballueshmërinë financiare të shërbimit të energjisë;
 - (viii) Nxitjet tarifore rregullatore për efikasitetin e energjisë.

Ky dokument i shkurtër analizon situatën e zbatimit të legjislacionit të efikasitetit të energjisë në Shqipëri, veçanërisht të ligjit të Efikasitetit të Energjisë dhe ligjit për Performancën e Energjisë së Ndërtesave dhe synon të identifikojë sfidat dhe mundësinë për arritjen e këtyre objektivave si dhe të propozojë hapat që duhen ndërmarrë nga aktorë të ndryshëm për të plotësuar këto objektivat.

Situata aktuale

Zbatimi i legjislacionit të miratuar nën direktivat evropiane apo legjislacionin bashkëkohor ndërkombëtar vazhdon të mbetet një nga problemet kryesore të vendit tonë. Objektivat dhe zotimet që burojnë nga ligjet nuk shoqërohen me akte nënligjore dhe rregullore përkatëse, të cilat do ta bëjnë të mundur zbatimin e këtyre ligjeve. Kësaj "sëmundjeje" nuk i ka shpëtuar as legjislacioni mbi efikasitetin e energjisë, i cili përveç vonesave vendore, përbën një sektor me zhvillim të shpejtë përse i përket dispozitave dhe rregullore që hartohen në nivel ndërkombëtar.

Bazuar mbi këto problematika që ndeshen edhe në vende të tjera të rajonit, Bashkimi Evropian ka krijuar një varg mekanizmesh për t'iu ofruar asistencë, por edhe për t'i monitoruar përpjekjet e vendeve aspiruese për krijimin e kornizës përkatëse ligjore dhe harmonizimin e saj me vendet e BE-së. Rolin e institucionit asistues dhe monitorues në fushën e politikave energjetike e luan Sekretariati i Komunitetit të Energjisë me seli në Vjenë. Gjithashtu donatorë të ndryshëm si (GIZ, PNUD, BERZH etj) ofrojnë asistencë teknike për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë në arritjen e objektivave të marra nga vendi ynë në këtë sektor.

Më konkretisht, në mënyrë që të nisë zbatimi i Ligjit për "Efikasitetin e Energjisë" dhe Ligjit „Për performancën e energjisë së ndërtësive" si dhe masave të parashikuara për përmirësimin e situatës në këtë sektor, nevojitet që të përgatiten aktet nënligjore dhe kuadri përkatës rregullator.

Situata e deritanishme e hartimit të këtyre akteve paraqitet në tabelat e mëposhtme, bazuar mbi raportimin e detyruar vjetor të autoriteteve shqiptare pranë Komunitetit të Energjisë në Vjenë.

Tabela 1: Statusi i përgatitjes së akteve nënligjore të Ligjit për Eficiência e Energjisë

AKTI LIGJOR	BAZA LIGJORE PRIMARE	AUTORITETI PERGJEGJES	HARTIMI	PËRSHTATJA/VLEFSHMERIA	KOMENTET / STATUSI I PAJTUESHMËRISË
Vendimi për përshtatjen e planit të veprimit kombëtar të efijencës së energjisë	Neni 7(1) i ligjit për përdorimin efijent të energjisë	Këshilli i Ministrave	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë	Përshtatur / Fletorja ZyrtareNr.2 11.12.2017	- Zhvilluar Plani i Dytë dhe i Tretë me mbështetjen e programit REEP dhe ECS - EED në bashkëpunim me TBC
Raporti vjetor për implementimin e planit të veprimit kombëtar të efijencës së energjisë	Neni 8(5) i ligjit për përdorimin efijent të energjisë	Këshilli i Ministrave	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë	Nuk është përshtatur Afati: 11.12.2018	
Metodologjia për monitorimin e implementimit të Planit të Veprimit Kombëtar për Efijencën e Energjisë / forma dhe shpeshtësia e raportimit	Neni 8(1) i ligjit për përdorimin efijent të energjisë	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës së Republikës së Shqipërisë	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë	Përshtatur Fletorja Zyrtare Nr. 792, 09.11.2016	Metodologjia për monitorimin dhe verifikimin e zbatimit të PKVEE/formati dhe periodiciteti i raportimeve të përgatitur nga GIZ ORF-EE (bottom-up); Miratuar nëFZ Nr. 792, 09.11.2016;
Politika kombëtare për efijencën dhe kursimet e energjisë	Neni 5(5) i ligjit për energjinë elektrike	Këshilli i Ministrave	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë / Agjencia për Efijencën e Energjisë	Nuk është përshtatur Afati: 27.11.2016	
Vendimi mbi themelimin dhe funksionimin e Agjencisë për Efijencën e Energjisë	Neni 25(1) i ligjit për përdorimin efijent të energjisë	Këshilli i Ministrave	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë	Përshtatur/ Fletorja zyrtareNr.852 07.12.2016	Agjencia e është themeluar; Kryetari i Agjencisë është zgjedhur, zyrrat janë zgjedhur, Departamenti i Shërbimit Publik pranë Kryeministrit po zgjedh stafin i cili do të përbëhet nga 10 ekspertë: 3 inxhinierë; 3 eko-nomistë dhe 3 juristë

Rregullorja për kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit dhe përvojën profesionale për licencimin e auditimeve të energjisë dhe ofruesit e shërbimeve energjetike	Neni 17(2) , 18 (3) i ligjit për energjinë elektrike	Këshilli i Ministrave	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë	Nuk është përshtatur Afati: 27.11.2016	Draft VKM është përgatitur për metodiken e realizimit të auditimit energjetik (ndërtesa, industri, transport) dhe për licencimin e auditorëve të energjisë (ndërtesa, industri, transport)
Rregullorja për kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit dhe përvojën profesionale për licencimin e menaxherëve të energjisë	Neni 10(4) i ligjit për energjinë elektrike	Këshilli i Ministrave	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë	Nuk është përshtatur Afati: 27.11.2016	
Vendimi mbi themelimin e fondit për eficientë e energjisë dhe kriteret për emërimin e anëtarëve të bordit dhe drejtorit ekzekutiv	Neni 19-24 i ligjit për energjinë elektrike	Këshilli i Ministrave	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë	Nuk është përshtatur Afati: 27.11.2016	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës së bashku me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit si dhe Njësinë e Ndryshimeve Klimatike (sponsorizuar nga UNDP) ka përgatitur Studimin e Fisibilitetit për krijimin e Fondit të EE
Fondi për eficientë e energjisë: statuti, manuali operacional	Neni 19-24 i ligjit për energjinë elektrike	Këshilli i Ministrave	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë	Nuk është përshtatur Afati: 27.11.2016	Ju lutem lexoni më sipër
Rregullat dhe procedurat për prokurimet publike të EE	Neni 9(1) i ligjit për energjinë elektrike	Këshilli i Ministrave	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë	Nuk është përshtatur Afati: 27.11.2016	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës ka filluar përgatitjet e këtyre rregullave
Vendimi për themelimin dhe formatin e bazës së të dhënave të EE-së	Neni 13(1) i ligjit për energjinë elektrike	Këshilli i Ministrave	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë	Nuk është përshtatur Afati: 27.11.2016	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës ka filluar përgatitjet për themelimin dhe formatin e bazës së të dhënave të energjisë në pergjithësi dhe të EE në veçanti
Urdhri për formatin dhe afatet e dorëzimit të të dhënave dhe informacionit për bazën e të dhënave të EE-së	Neni 13(8) i ligjit për energjinë elektrike	Këshilli i Ministrave	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë	Nuk është përshtatur Afati: 27.11.2016	Ju lutem lexoni më sipër

Udhëzim për përcaktimin, matjen dhe shpërndarjen e konsumit të energjisë termike	Neni 14(3) i ligjit për energjinë elektrike	Këshilli i Ministrave	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë	Nuk është përshtatur Afati: 27.11.2016	
Udhëzim për llojin dhe shpeshtësinë e Informacionit për efiçencën e energjisë dhe trajnimi që do të sigurohet nga Agjencia	Neni 15(4) i ligjit për energjinë elektrike	Këshilli i Ministrave	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë	Nuk është përshtatur Afati: 27.11.2016	
Kontratat standarde për shërbimet e energjisë të ofruara në kuadër të programeve të financuara nga fondi për efiçencën e energjisë	Neni 18(5) i ligjit për energjinë elektrike	Këshilli i Ministrave	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë	Nuk është përshtatur Afati: 27.11.2016	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës me mbështetjen e EBRD-së ka përgatitur draft kontratat EPC-ESCO dhe ESCO
Raporti i parë vjetor mbi progresin e arritur në drejtim të objektivave kombëtare të efiçencës së energjisë	Neni 24(1) i direktivës 201/27/EU	Këshilli i Ministrave	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë / Agjencia për Efiçencën e Energjisë	Nuk është përshtatur Afati: 30.06.2017	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës ka filluar përgatitjet mbi progresin e arritur në drejtim të objektivave kombëtare të efiçencës së energjisë

Tabela 2: Statusi i përgatitjes së akteve nënligjore të Ligjit Për Performancën

Energjetike të ndërtesave (nr.116/2016, 10.11.2016)

AKTI LIGJOR	BAZA LIGJORE PRIMARE	AUTORITETI PERGJEGJES	HARTIMI	PERSHTATJA/VLEFSHMERIA	KOMENTET / STATUSI I PAJTUESHMERISË
Vendim për miratimin e metodologjisë për llogaritjen e performancës energjetike të ndërtesave dhe njërive të ndërtimit	Neni 5(8)	Këshilli i Ministrave	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë / Agjencia për Efçencën e Energjisë	Nuk është përshtatur, drafti fillestar, Afati: 25.11.2017	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës ka filluar përgatitjet, mbështetur nga EBRD-ja, mbi Vendim për miratimin e metodologjisë për llogaritjen e performancës energjetike të ndërtesave dhe njërive të ndërtimit
Vendimi për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë për ndërtesat dhe elementet e ndërtimit	Neni 6(5)	Këshilli i Ministrave	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë / Agjencia për Efçencën e Energjisë	Nuk është përshtatur, drafti fillestar, Afati: 25.11.2017	Ju lutem lexoni më sipër
Vendim për miratimin e metodologjisë për llogaritjen e nivelit optimal të koston së ndërtesave, njërive ndërtimore dhe elementëve të ndërtimit	Neni 7(1)	Këshilli i Ministrave	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë / Agjencia për Efçencën e Energjisë	Nuk është përshtatur, drafti fillestar, Afati: 25.11.2017	Ju lutem lexoni më sipër
Plani kombëtar për rritjen e numrit të ndërtesave me energji afërsisht zero	Neni 9(1)	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë / Agjencia për Efçencën e Energjisë	Nuk është përshtatur, drafti fillestar, Afati: 25.11.2017	
Udhëzimi mbi tarifat e pragut për ekspertët që lëshojnë Çertifikatën e Performancës së Energjisë (CPE)	Neni 10(6)	Këshilli i Ministrave	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë / Agjencia për Efçencën e Energjisë	Nuk është përshtatur, drafti fillestar, Afati: 25.11.2017	

Vendimi për miratimin e procedurave dhe kushteve të çertifikimit të performancës së energjisë së ndërtësës; software kombëtar të çertifikimit	Neni 10(7)	Këshilli i Ministrave	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë / Agjencia për Efiçencën e Energjisë	Nuk është përshtatur, drafti fillestar, Afati: 25.11.2017	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës ka përgatitur Draft Vendimin (asistuar nga EBRD-ja) e procedurave dhe kushteve të çertifikimit të performancës së energjisë së ndërtësës; software kombëtar të çertifikimit
Vendimi për miratimin e kriterëve dhe procedurave të verifikimit për CPE	Neni 13(6)	Këshilli i Ministrave	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë / Agjencia për Efiçencën e Energjisë	Nuk është përshtatur, drafti fillestar, Afati: 25.11.2017	
Vendimi për miratimin e kategorive të ndërtësave, të cilat do t'i nënshtrohen përjashtimit	Neni 4(6)	Këshilli i Ministrave	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë / Agjencia për Efiçencën e Energjisë	Nuk është përshtatur, drafti fillestar, Afati: 25.11.2017	

(Të dhënat nga Komuniteti i Energjisë në Vjenë i referohen raportimeve deri në mars 2018)

Nga hulumtimi dhe intervistimi i aktorëve të përfshirë në këtë proces, mund të nënvizohet gjithashtu se deri në muajin tetor 2018 situata e hartimit të akteve nënligjore dhe ngritjes së institucioneve të parashikuara në dy ligjet e lidhura me eficiency e energjisë është si më poshtë:

Krijimi i Agjencisë së Eficiency së Energjisë (AEE) - Agjencia e Eficiency së Energjisë është themeluar; Kryetari i Agjencisë është zgjedhur, më konkretisht znj, Entela Çipa; është përcaktuar gjithashtu godina ku do të veprojë ky institucion.

Situata e zbatimit: Mbetet për t'u përcaktuar struktura e stafit (Departamenti i Administratës Publike ka hapur procedurat e rekrutimit për 10 ekspertë: 3 inxhinierë; 3 ekonomistë dhe 3 juristë). Pritet që në buxhetin e vitit të ardhshëm të jenë edhe fondi i nevojshëm për funksionimin e Agjencisë së Eficiency së Energjisë.

Afati i përcaktuar në ligj: Brenda 12 muajve të parë (Dhjetor 2016)

Krijimi i Fondit të Eficiency së Energjisë (FEE) - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë së bashku me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit si dhe Njësinë e Ndryshimeve Klimatike (mbështetur nga PNUD) ka përgatitur Studimin e Fisibilitetit për krijimin e Fondit të EE.

Situata e zbatimit: Dokumentat e mësipërme janë paraqitur për miratim në Këshillin e Ministrave dhe pritet miratimi

Afati i përcaktuar në ligj: Brenda 12 muajve të parë (Dhjetor 2016)

Plani Kombëtar i Veprimeve i Eficiency së Energjisë (PKVEE) - Drafti i PKVEE për periudhën 2016 - 2020 është përgatitur dhe po mblidhen komentet nga institucionet, të cilat janë të përfshira apo preken nga ky plan. Një nga përfitimet, por dhe një nga detyrat që parashikon realizimi i PKVEE është zhvillimi i një database energjetike për çdo sektor të ekonomisë dhe për çdo burim të energjisë; Përditësimi i tij dhe kryerja e analizave të nevojshme, jo vetëm për përcaktimin e trendeve të konsumit të burimeve të energjisë, ndryshimet e mundshme të vetë konsumit të lëndëve energjetike por edhe reduktimin (nëse) për njësi prodhimi apo shërbimi që vihet re para dhe mbas zbatimit të masave për zbatimin e eficiency së energjisë.

Metodologjitë për llogaritjen e performancës energjetike të ndërtesave dhe njësive të ndërtimit - Situata e zbatimit: Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës ka filluar përgatitjet, mbështetur nga BERZH, mbi Vendimin për miratimin e metodologjisë për llogaritjen e performancës energjetike të ndërtesave dhe njësive të ndërtimit.

Afati i përcaktuar në ligj: Brenda 12 muajve të parë (25/11/2017)

Procedurat dhe kushtet e çertifikimit të performancës së energjisë së ndërtesës; Software kombëtarë të çertifikimit - Situata e zbatimit: Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës ka përgatitur Draft Vendimin (asistuar nga EBRD-ja) e procedurave dhe kushteve të çertifikimit të performancës së energjisë së ndërtesës; software kombëtarë të çertifikimit.

Afati i përcaktuar në ligj: Brenda 12 muajve të parë (25/11/2017)

Përfundime

Siç mund të vihet re nga analiza e mësipërme e situatës në sektorin e efijencës së energjisë ka ende shumë punë për të bërë në lidhje me objektivat që janë përcaktuar në legjislacionin përkatës. Nga 16 akte nënligjore dhe rregullore të detyrueshme për të zbatuar zotimet e përcaktuara, deri në muajin mars 2018, janë miratuar vetëm 3 prej tyre.

Në lidhje me pjesën tjetër të akteve nënligjore mund të thuhet se është bërë një punë e kënaqshme nga hartuesit pranë institucioneve përgjegjëse si Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ndërkohë që kësaj shtate nuk i përgjigjet me të njëjtën shpejtësi edhe pjesa tjetër e institucioneve qendrore si Këshilli i Ministrave. Këto vonesa rrezikojnë që të mbajnë pezull krijimin e institucioneve të reja (Fondi i Efijencës së Energjisë) edhe për shumë muaj të tjerë. Konsulentët nuk kanë arritur të marrin një përgjigje për ecurinë e këtyre projekt akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave deri në momentin e finalizimit të këtij punimi.

Disa nga arsyet që konsulentët mundën të identifikonin për këto vonesa të paraqitura në tabelat 1 dhe 2 janë renditur më poshtë:

1. Konstrukti institucional aktual pranë ministrisë dhe institucioneve të linjës si dhe Këshillit të Ministrave, është i pamjaftueshëm për të bërë të mundur realizimin në kohë të të gjitha detyrave që ngarkohen në lidhje me sektorin e efijencës së energjisë;
2. Mbështetja nga donatorët në këtë fushë ka qenë e mangët si me ekspertizë po ashtu dhe me fonde për të përballuar fluksin e madh të punës që kërkohet për të zbatuar objektivat e kërkuara;
3. Fokusimi në axhenda dhe sektorë të tjerë krijon shpesh mungesë të vullnetit politik nga nivele vendimmarrëse për të bërë të mundur implementimin e plotë të legjislacionit në këtë sektor të rëndësishëm.

Rekomandime

Arritja e objektivave të efikasitetit të energjisë dhe një zhvillim të qëndrueshëm të energjisë mbetet ende një sfidë e vështirë për vendin tonë. Asnjë masë e vetme nuk do të shmangë problematikat me të cilat ballafaqohet Shqipëria, ashtu si dhe vende të tjera në rajon, në zbatimin e detyrimeve dhe standarteve të larta të përcaktuara nga Bashkimi Evropian. Vetëm një paketë gjithëpërfshirëse e ndërgjegjësimit dhe informimit mbi masat ligjore, financiare, fiskale dhe institucionale do të përmirësojë gradualisht situatën dhe do ta afrojë Shqipërinë drejt standardeve moderne në fushën e efikasitetit të energjisë.

Duke u bazuar në analizën e situatës dhe potencialit që ekziston për të ndihmuar në çuarjen përpëra të agjendës së energjisë, ofrohen disa rekomandime përkatëse.

Rekomandime për politikëbërësit dhe vendimmarrësit

Me qëllim përballjen e të gjitha këtyre sfidave për hartimin e akteve nënligjore brenda afateve të përcaktuara, ngritjen e institucioneve të parashikuara si dhe krijimin e premisave për zbatimin e masave të parashikuara për efikasitetin e energjisë rekomandohet që:

- Të shtohen burimet njerezore vendase dhe të nxitet përfshirja e ekspertizës së huaj nëpërmjet donatorëve, për plotësimin e të gjitha akteve nënligjore dhe rregulloreve të tjera, të cilat mbajnë pezull ngritjen e institucioneve të reja dhe nisjen e zbatimit të ligjit për Efikasitetin e Energjisë. Përfshirja e ekspertëve nga bota akademike apo biznesi privat në hartimin e këtyre dokumentave rregulluese të nivelit të dytë, mund të jetë një tjetër mundësi për përsheptimin e axhendës dhe arritjen e afateve të parashikuara.
- Kërkohet një angazhim më i madh i vendimmarrësve në institucionet qendrore (Këshilli i Ministrave, Ministria e Energjisë, AKBN etj) dhe bashkërendim mes tyre për të çuar përpara axhendën dhe detyrimet e përcaktuara nga ligji. Për shkak të fokusimit tek reforma në sektorë të tjerë, ka një mungesë të vëmendjes së duhur për fushën e Efikasitetit të Energjisë. Ngritja e grupeve ad-hoc ndër-institucionale me përfshirjen edhe të aktorëve të tjerë në këtë sektor, mund të nxisë kapërcimin e këtyre vonësive nga vendimmarrësit.
- Përkundër mbështetjes financiare të kërkuar për arritjen e objektivave të përcaktuara, ky sektor vuan nga mungesa e informimit dhe ndërgjegjësimit të vendimmarrësve rreth objektivave dhe zotimeve të marra. Si rrjedhojë, konstatohet mungesë përgjegjësie për zbatimin e legjislacionit si dhe presioni i duhur ndaj institucioneve qendrore dhe atyre vendore. Roli i parlamentarëve për nxitjen e politikave dhe mekanizmave kontrolluese, mbetet ende një potencial i pashfrytëzuar dhe duhet të promovohet më tej.

- Krijimi i mekanizmave të monitorimit të vazhdueshëm të agjendës së Efëçencës së Energjisë do të ndihmonte në nxitjen e respektimit të afateve ligjore dhe presionit pozitiv për të gjithë aktorët e ngarkuar me detyrime nga ligji. Ky monitorim nuk mund të lihet në dorë vetëm të organizmave ndërkombëtarë si Komuniteti i Energjisë, por kërkon një angazhim të vazhdueshëm të programeve të donatorëve dhe aktorëve të shoqërisë civile.

Rekomandime mbi sfidat e lidhura me zbatimin e kuadrit ligjor

Për të mbështetur zbatimin e qëndrueshëm të PKVEE-së të 2-të dhe të 3-të (VKM 719/2016) propozohen rekomandime për mekanizmat e financimit dhe stimujt fiskalë në Shqipëri, me qëllim për të zbatuar të gjitha masat e parashikuara në skenarin për EE të strategjisë.

Një paketë e tillë duhet të përfshijë:

- Vazhdimin e transpozimit të plotë të dy ligjeve (124/2015 dhe 116/2016) për EE dhe miratimin e rregulloreve teknike dhe legjislacionit dytësor, të cilat duhet të përgatiten në periudhën afatshkurtër brenda 2019-es;
- Plotësimin e Agjencisë së Efëçencës së Energjisë me staf dhe vënien e saj në funksion të plotë, si struktura kryesore për zbatimin e EE;
- Ngritjen e kapaciteteve në të gjitha nivelet;
- Fushatat e vazhdueshme të ndërgjegjësimit;
- Konsulencën e përhershme dhe informacione teknike mbi EE për të gjithë konsumatorët e energjisë;
- Krijimi i Fondit të Efëçencës së Energjisë, si person juridik, me statusin e një organizate jofitimprurëse që synon të sigurojë mbështetje financiare dhe menaxhim projektsh për zhvillimin e një tregu të përmirësimit të efëçencës së energjisë dhe programeve mbështetëse për konsumatorët fundorë me investime me kosto dhe risk relativisht të lartë;

Rekomandime të stimujve për investim në efëçencën e energjisë

Duke pasur parasysh rëndësinë e masave të efëçencës së energjisë (EE) që përfshijnë edhe shfrytëzimin e Burimeve të Rinovueshme të Energjisë (BRE), më poshtë janë shqyrtuar masat specifike të financimit dhe stimujt fiskalë bazuar në praktikat më të mira të identifikuara nga vendet anëtare të BE-së, sidomos nga anëtarët e rinj.

Mekanizmat dhe stimujt financiarë

Mekanizmat Financiarë	Fondet Qarkulluese	Mekanizmat Fiskalë	Zbritjet nga detyrimet e taksave
	Huatë Preferenciale		Ulja e taksave
	Subvencionet		Ulja e TVSH-së
	Grantet		Taksat e karbonit
	Garancitë e Huave	Tarifat e energjisë	Fondi Publik EE
	Asistencë teknike për përgatitjen e huave		Programi DSM në Financë i drejtuar nga shërbimet
	Financimi i Palëve të Treta		Investimet e përbashkëta për konsumatorët nga ana e kompanive të shërbimeve të furnizimit të energjisë për të ulur nivelin e kërkesës
	Kontrata e Performancës së Energjisë		
	Tregtimi (Çertifikata Energjetike).		

Tabela e mësipërme tregon llojet e stimujve që janë zbatuar nga Shtetet Anëtare të BE-së për të ndihmuar arritjen e synimeve të vendosura në PKVEE të ndryshme.

Burimet

- 1- **Arkiva e Qendrës së Botimeve Zyrtare** – Fletore zyrtare të publikimit të legjislacionit përkatës
- <http://www.qbz.gov.al/>
- 2- **Databaza e akteve nënligjore e Komunitetit të Energjisë në Vjenë – Seksioni Shqipëria**
- <https://energy-community.org/implementation/Albania/secondary.html>

